Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**02.11.2026**	**09.11.2026**	**2026/0839**


BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.10.2026, OE "Shaip S. Haxhiu B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0839, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "HPI shpk"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "083-5969-Furnizim me material per mirembajtje, pastrim dhe permiresimin e kushteve ne lokalitetet arkeologjike" me nr. të prokurimit: "207-26-5969-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Kultures dhe Turizmit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 30,420.00 €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE



IV. DISPOZITAT LIGJORE PËR TË CILAT KËRKOHET VERIFIKIMI

Në bazë të fakteve të paraqitura, kërkojmë që OSHP-ja të shqyrtojë zbatimin e dispozitave përkatëse të LPP-së, veçanërisht:

- **Neni 1** – qëllimi dhe parimet e prokurimit publik.
- **Neni 7** – barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi.
- **Neni 59** – ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
- **Neni 60** – kriteret për dhënien e kontratës.
- **Neni 108/A** – shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues.
- **Neni 109** – e drejta për paraqitjen e ankesës në OSHP.

Kërkojmë që OSHP-ja të identifikojë edhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme që mund të jetë cenuar, nëse kjo vërtetohet nga dokumentacioni i procedurës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **Kërkesa numër 1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmitë për kërkesën nr.1. Certifikatë valide të regjistrimit të biznesit – kopje dhe dokumentet përcjellëse**
		Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhet ta paraqes edhe dokumentin për regjistrim të TVSH-së	**Dëshmitë për kërkesën nr.2. Kopja e vërtetimit të regjistruar si OE tatimpagues i TVSH-së**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar** **n a**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **n a**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi një listë të kontratave se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Për kërkesën me nr 1 Operatori Ekonomi duhet të ofrojë dëshmi si në vijim Listen Kontratave të nënshkruar dhe të vulosur. Ku furnizimet janë kryer për një Autoritet Publi në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshm duhet të dorëzohet çertifikata e pranimit os referenca pozitive të lëshuar nga autoriteti i till Kur furnizimet janë kryer për një blerës priva pranohet kopja e çdo dokumenti që është nënshkruar nga blerësi dhe kryerësi i furnizimev**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËSREPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT
MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

083-5969-Furnizim me material për mirëmbajtje, pastrim dhe përmirësimin e kushteve në lokalitetet arkeologjike

Nr. i prokurimit	207-26-5969-1-2-1
Nr. i brendshëm	207-26-083-1-2-1

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës	Statusi
1.	**" HPI " SH.P.K. Prishtinë, Prishtinë 810153750**	**23645.00 €**	**I suksesshëm**
2.	E3 Group SH.P.K. Rr. Eqrem Qabej, 3., 811857400	29740.00 €	I pasuksesshëm
3.	" I.P.N.EU " SH.P.K. ASLLAN PIREVA 551 810079154	29069.00 €	I pasuksesshëm
4.	TONI O.P. Kërvasari, Malishevë 811152420	25870.00 €	I pasuksesshëm
5.	Shaip S. Haxhiu B.I. zona industriale, prishtine 810441270	23645.00 €	I pasuksesshëm

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Ministria e Kulturës dhe Turizmit shpërblen me kontratë:

1.	**" HPI " SH.P.K. Prishtinë, Prishtinë 810153750**	**23645.00 €**

Data: **14.10.2026**
Valbone ZEKAJ

Zv. Drejtor i Prokurimit/MKT

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Shaip S. Haxhiu B.I.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me njoftimin mbi Vendimin (B58) të AK – Ministria e Kulturës dhe Turizmit, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-se, duke rekomanduar per kontrate OE të papergjegjshem dhe njeherit pretendon se AK nuk i ka respektuar afatet ligjore të procedurave të prokurimit.

Pretendimi nr. 1

OE ankues pretendon se AK - Ministria e Kulturës dhe Turizmit, nuk i ka respektuar afatet për nxjerrjen e vendimeve, duke pretenduar se janë shkelur afatet pas dorëzimit te kërkesave tone.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me date: 15.10.2026 ndersa AK ka nxjerr vendimin brenda afatit ligjore, konkretisht me datën: 21.10.2026 dhe poashtu sqaroj se afati i vlerësimit të ofertave është bere ne harmoni me nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik. Prandaj, ky pretendim nuk qëndron.

Pretendimi nr. 2

OE ankues, pretendon se me rastin e parashtrimit te kërkesës për rishqyrtim autoriteti kontraktues, nuk është përgjigjur ne tërësi ne pretendimet tona te dorëzuara pran AK-se, konkretisht pretendon se AK nuk ka vepruar ne harmoni te plote me nenin 108/A te LPP-se. Eksperti shqyrtues, pas analizimit te vendimit te kërkesës për rishqyrtim vlerëson se nuk qëndron pretendimi për shkelje procedurale për faktin se OE ankues ka pasur një pretendim lidhur me çmimin e ofertës se OE te rekomanduar për kontrate dhe për te njëjtin pretendim, AK i ka dhënë përgjigje.

Pretendimi nr. 3

OE ankues kërkon të dhëna të sakta, lidhur me kohen e dorëzimit të ofertës se OE te rekomanduar për kontrate, sepse sipas procesverbalit te hapjes se ofertave, oferta e OE ankues dhe oferta e OE te rekomanduar për kontrate, janë me çmim te njëjtë: 23.645.00€ dhe ne rastin konkret AK sipas legjislacionit e ka rekomanduar për kontrate ofertën e cila është dorëzuar me herët dhe sipas te dhënave ne platformën E-Prokurimit, rezulton se oferta e OE HPI është dorëzuar (e para) pra më herët.

Sipas platformës se E-Prokurimit:


Oferta e OE të rekomanduar për kontrate: **14.08.2026 10:12.**

Oferta e OE ankues: **14.08.2026 11:43.**

Pretendimi nr. 4

OE ankues, pretendon se oferta e OE te rekomanduar për kontrate, ka mospërputhje te çmimit, sepse autoriteti kontraktues, ne njoftimin për dhënie e ka publikuar çmimin prej: 23.645.00€, ndërsa ne vendimin B58 ka dhënë çmimin prej: 25,870.00€.

Eksperti shqyrtues, sqaron se lidhur me këtë pretendim AK ka dhëne përgjigje ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim, duke deklaruar se behet fjale për një gabim teknik gjate përpilimit te dokumentit dhe se çmimi i ofertës është po i njëjti me procesverbalin e hapjes: 23.645.00€.



Pretendimi numër 1 – Refuzohet si i pa bazuar mbi arsyeshmerine si vijon:
Bazuar ne dokumentacionin e kompanisë fituese HPI SHPK, ne kërkesën për sqarime shtese, ne refe
e institucioneve dhe deklaratën e kompanisë se do ti realizoi te gjitha furnizimet sipas specifikimeve t
dhe çmimit me te lire ne oferte *(çmimi me i lirë i dorëzuar i pari)* ne vlere financiare 23645.00€ para
se OE i shpallur fitues i ka plotësuar te gjitha kriteret ne Formularin e te Dhënave të Tenderit (FDT).
me ndryshimet ne çmim është një gabim teknik i lëshuar gjate hartimit të Njoftimit mbi Vend
Autoritetit Kontraktues dhe se ky gabim nuk ndikon asgjë ne rezultatin final te procedurës. OE i sh
fitues do te ekzekutoi kontratën ne vlere financiare 23645.00 Euro për të gjitha produktet ne parama

Pretendimi nr. 5

OE ankues, pretendon se AK ka rekomanduar për kontrate OE te papërgjegjshëm dhe njeherit kërkon nga OSHP, verifikimin e te gjithë dokumentacionit te ofertës se OE te rekomanduar për kontrate.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se AK- ne dosje te tenderit, përveç kërkesave te përshtatshmërisë ku përfshihen certifikatat e biznesit, certifikata e TVSH-se, vërtetimet e ATK-se dhe Gjykatës, ka parashtruar vetëm një kërkesë tjetër te kriteret teknike dhe profesionale ku ka kërkuar qe:

1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi një listë të kontratave se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit te ofertës se OE të rekomanduar për kontrate, sqaron se i rekomanduari për kontrate e ka dorëzuar listën e kontratave sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Kulturës dhe Turizmit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Shaip S. Haxhiu B.I.**

Florije Rexhepi